



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Projekti për Nxitjen dhe Shfrytëzimin e Mundësive për Sigurinë e Ujit (FLOWS)

NJOFTIM PUBLIK

për organizimin e dëgjimit publik për dokumentet "Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social", "Korniza e Politikave të Zhvendosjes" dhe "Korniza e Angazhimit të Palëve të Interesit" për Projektin Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit (FLOWS)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës, përmes Qeverisë së Kosovës, ka paraqitur një kërkesë në Bankën Botërore për fonde që synojnë përmirësimin e kapacitetit institucional për transformimin e integruar për menaxhimin e burimeve ujore dhe tokësore dhe investimeve katalitike shumë-sektoriale në një zonë të synuar.

Dokumentat e mëposhtëm janë përgatitur për të identifikuar me kohë ndikimin e mundshëm negativ mjedisor dhe social nga realizimi i aktiviteteve të projektit dhe angazhimi i palëve të interesuara:

- **Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social**
- **Korniza e Politikave të Zhvendosjes**
- **Korniza e Angazhimit të Palëve të interesit**

Dokumentet janë përgatitur në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e Bankës Botërore.

Gjithashtu dokumentet janë vënë në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (<https://mmph.rks-gov.net/>). Komentet tuaja mund të drejtohen tek Z. Fidan Bilalli në adresën e mëposhtme të postës elektronike: fidan.bilalli@rks-gov.net ose mund të dërgohen me shkrim në adresën në vijim: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ndërtesa e ish-"Rilindja", 10000 Prishtinë, brenda 14 ditëve nga data e postimit të dokumenteve në faqen e internetit.

Prezantimi i gjetjeve kryesore të dokumenteve të përgatitura do të bëhet në seancën dëgjimore publike që do të mbahet në ambientet e Kuvendit Komunal Kamenicë, datë 27.02.2020 në orën 10.

Procesverbali nga seanca dëgjimore do t'u dërgohet të gjithë palëve të interesuara që kanë paraqitur komentet përmes kontakteve të tyre (adresat e postës elektronike / adresat postare të paraqitura).

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor fton të gjithë akterët, institucionet dhe individët që të marrin pjesë në dëgjimin publik për dokumentet kornizë për projektin që të japin komentet dhe sugjerimet e tyre.